



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

**NJOFTIM PARAPRAK PËR PËRJASHTIM NGA NDALIMI I
MARRËVESHJES**

Marrëveshje bashkëpunimi midis ndërmarrjeve: “Sigal Uniqa Group Austria” SHA, “Intersig VIG” SHA, “Atlantik” SHA, “Sigma Inter-albanian VIG” SHA, “Albsig” SHA, “Eurosig” SHA, “Ansig” SHA, “Insig” SHA

Në datën 10.01.2018, Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 49, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar) ka marrë njoftimin nga ndërmarrjet “Sigal Uniqa Group Austria” SHA, “Intersig VIG” SHA, “Atlantik” SHA, “Sigma Inter-albanian VIG” SHA, “Albsig” SHA, “Eurosig” SHA, “Ansig” SHA, “Insig” SHA”, për përjashtimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet tyre Nr. 16, datë 01.10.2017, lidhur me shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil.

Autoriteti i Konkurrencës fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për marrëveshjen e njoftuar, jo më vonë se 30 ditë, nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al